



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPËSTINA VUÇITEN
02 Nr. / Br 54/18
Nr. i fq. / Br. st _____
Data: / Datum 12.01.2018
VUSHTRRI - VUÇITEN



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 11 pika 1 dhe nenit 18 pika 1 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores nr.02/2010 për Rekrutimin e Nëpunësve Civil, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M PËR ANULIM TË KONKURSIT

1. Anulohet konkursi nr.761/17 i datës 23.06.2017, për vendin e punës Zyrtar për Gjeodezi, në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Vushtrrisë .
2. Anulimi i këtij konkursi bëhet për shkak se nuk janë respektuar procedurat, kriteret dhe afatet e rekrutimit bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil dhe Rregulloren për Rekrutimin e Nëpunësve Civil .
3. Me rastin e ri shpalljes së konkursit kandidatët të cilët kanë aplikuar në konkursin që anulohet, nuk kanë nevojë që të sjellin dokumentacion tjetër të kërkuar me konkursin e rishpallur përveç aplikacionit për punësim.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Njësia e Personelit të Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
6. Vendimi u dërgohet: Zyrës së Personelit, Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri